

**RYDE**

Regional Youth Dialogue  
for Europe



Funded by  
the European Union

# Përmbledhje E Përfundimeve Kyçe Analiza Krahasuese E Politikave Të Rinisë Në Balkanin Perëndimor





**Koordinatori i Analizës krahasuese:**

Mona Xhexhaj, Akademia e Intergrimeve dhe Negociatave Europiane (Shqipëri)

**Pjesëmarrësit në studim:**

Aleksandra Jerkov  
Vladimir Mentus  
Sarita Bradash  
Brikena Berisha  
Maja Jovanovska  
Lutjona Lula  
Aleksandar Ivković  
Rozafa Berisha  
Vasko Magleshov  
Anisa Lloja  
Hata Kurjaković  
Sead Dzigal

**Shtator 2024.**



*\*Këtë botim e financoi Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Akademisë së Integrimeve dhe Negociatave Evropiane dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

# Përmbajtja

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>1. FUSHA SOCIO-EKONOMIKE</b> .....	<b>7</b>
<b>1.1. PUNËSIMI – PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>7</b>
1.1.1. Garancitë për të rinj.....	8
1.1.2. Rekomandimet për fushën e punësimit në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Garancinë për të rinjtë.....	9
<b>1.2. ARSIMI - PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>10</b>
1.2.1. Rekomandimet për arsim .....	10
<b>1.3. SHËNDETI SEKSUAL DHE RIPRODHUES – PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>11</b>
1.3.1. Rekomandimet në fushën e SHSR .....	12
<b>2. PJESËMARRJA E TË RINJVE – PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>14</b>
2.1. Rekomandimet për pjesëmarrjen e të rinjve .....	15
<b>3. MEDIA, KULTURA DHE BOTA DIXHITALE</b> .....	<b>17</b>
<b>3.1. ARSIMIMI MEDIATIK – PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>18</b>
3.1.1. Rekomandimet për edukimin mediatik .....	18
<b>3.2. AFTËSITË DIXHITALE – PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>19</b>
3.2.1. Rekomandimet për aftësitë dixhitale .....	19
<b>3.3. POLITIKAT KULTURORE – PËRFUNDIMET KRYESORE</b> .....	<b>20</b>
3.3.1. Rekomandimet për politikat kulturore .....	21

Përmbledhje E  
Përfundimeve Kyçe  
Analiza Krahasuese  
E Politikave Të  
Rinisë Në Ballkanin  
Perëndimor

**RYDE**  
Regional Youth Dialogue  
for Europe



Funded by  
the European Union

# HYRJE





**Analiza Krahasuese e Politikave të Rinisë në Ballkanin Perëndimor (BP)** u realizua në kuadër të projektit **Dialogu Rajonal i Rinisë për Evropën (RYDE)** të cilin e financoi Bashkimi Europian (2023-2026). Projektin e udhëhoqi Fondacioni Qendra për Demokraci nga Serbia, në bashkëpunim me organizatat partnere të shoqërisë civile (OSHC) nga Ballkani Perëndimor, në mesin e të cilave janë Akademia e Integritimeve dhe Negociatave Evropiane (Shqipëri), Qendra Youth Act (Shqipëri), Iniciativa Kosovare për Stabilitet (Kosova\*<sup>1</sup>), Rrjeti i Iniciativave Progresive (Bosnjë dhe Hercegovinë), Fondacioni i Qendrës Informativë të OJQ-së (Maqedonia e Veriut), dhe Akademia Rajonale për Zhvillimi Demokratik (Serbi). Projekti synon të fuqizojë të rinjtë dhe OSHC-të, veçanërisht organizatat për të rinjtë, që të marrin pjesë aktive në dialogun e strukturuar me vendimmarrësit, për të përmirësuar bashkëpunimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe për të promovuar vlerat demokratike dhe përfitimet politike, ekonomike dhe sociale të integritimeve evropiane për shoqëritë e Ballkanit Perëndimor.

Kjo analizë synon të ofrojë **një pasqyrë të detajuar krahasuese në politikat publike që kanë të bëjnë me të rinjtë/rejat** në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë\*, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe në Serbi, duke përfshirë dokumentet e politikës siç janë strategjitë, planet e veprimt dhe ligjet. Analiza e vlerëson harmonizimin e masave të përshkruara në këto politika për të rinjtë me fusha të tjera të rëndësishme të politikës dhe vlerëson harmonizimin e këtyre politikave me nevojat e të rinjve, qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs) dhe nevojën për ndërtimin e qëndrueshmërisë sociale. Kjo analizë poashtu **formulon rekomandimet** për përmirësimin e politikave publike në secilën fushë të mbuluar nga ky hulumtim.

Kjo analizë fokusohet në **tri fusha kryesore të identifikuar si veçanërisht aktuale për të rinjtë/rejat** në Ballkanin Perëndimor:

- 1) Fusha socio-ekonomike:** punësimi, arsimi dhe shëndeti seksual dhe riprodhues;
- 2) Pjesëmarrja e të rinjve/rejave:** angazhimi qytetar dhe politik, përfshirja sociale dhe pjesëmarrja e të rinjve në procesin e vendimmarrjes;
- 3) Mediat, kultura dhe bota dixhitale:** mediat për të rinjtë/rejat dhe Arsimimi mediatik -dixhital dhe forcimi i të menduarit kritik, përfaqësimi i të rinjve/rejave në hapësirën mediatike, dukshmëria dhe afirmimi mediatik i të rinjve/rejave të grupeve të marginalizuara dhe pjesëmarrja e të rinjve/rejave në krijimin e politikave kulturore;

Kërkimin dhe analizën e të dhënave në kuadër të këtyre tri fushave e ka realizuar ekipi profesional prej 11 anëtarësh, duke përfshirë tre udhëheqës ekipi dhe tetë studiues nga Ballkani Perëndimor.

---

<sup>1</sup> Ky emërtim nuk i vë në pyetje qëndrimet për status dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB-së dhe Mëndimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Përmbledhje E  
Përfundimeve Kyçe  
Analiza Krahasuese  
E Politikave Të  
Rinisë Në Ballkanin  
Perëndimor


**RYDE**  
Regional Youth Dialogue  
for Europe



Funded by  
the European Union

1

# Fusha Socio-Ekonomike



# 1. Fusha Socio-Ekonomike

Fusha socio-ekonomike në kontekstin e kësaj analize përfshin:

- 1) Punësimin e të rinjve** dhe sfidat e veçanta me të cilat përballen të rinjtë për të hyrë në tregun e punës
- 2) Arsimi**, cilësia dhe rëndësia e sistemeve arsimore në rajon
- 3) Qasja në shërbime gjithëpërfshirëse **të shëndetit seksual dhe riprodhues** për të rinjtë në të gjithë rajonin.

Të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi **kanë një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike, ligjore dhe institucionale** që e rregullon fushën socio-ekonomike me rëndësi për të rinjtë.

Strategjitë Kombëtare për të rinjtë e përbëjnë kuadrin kryesor strategjik për të rinjtë në të gjitha fushat në të gjithë rajonin.

Në aspektin legjislativ, të gjitha **vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ligje të konsoliduara** në fushën e punësimit, arsimit dhe shëndetit seksual dhe riprodhues; megjithatë, ka shumë hapësirë për përmirësimin e këtyre ligjeve dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

## 1.1. Punësimi – Përfundimet Kryesore

Sipas *Studimit për punësimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor*<sup>2</sup> të cilin e publikoi Këshilli rajonal për bashkëpunim (RCC) nga Sarajeva, shkalla **mesatare e papunësisë së të rinjve në rajon është 35,1%**, që është dyfish më shumë sesa 14,5% në BE<sup>3</sup>. Të dhënat tregojnë për faktin se 23.7% e të rinjve në Ballkanin Perëndimor janë në NEET (nuk janë të punësuar, nuk janë në shkollë ose trajnim), që është më shumë se dyfishi prej 11.1% në BE. Shkalla e papunësisë së të rinjve/rejave në Bosnjë dhe Hercegovinë është ndër më të lartat në Evropë, dhe shumë të rinj po ballafaqohen me vështirësi që të gjejnë punë të qëndrueshme dhe me pagesë të denjë. Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor punësohen shpesh me kontrata të përkohshme për punë, me një pjesë joproporcionale të kontratave me kohë të pjesshme.

Për shkak të përhapjes së korrupsionit dhe nepotizmit në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor, që minojnë meritokracinë, ekziston një tendencë e de-profesionalizimit, ku të rinjtë/rejat shpeshëherë punojnë në punë që nuk përputhen me kualifikimet e tyre dhe vuajnë nga 'nënpunësia' (punojnë në punë nën nivelin e aftësive të veta). Sipas Studimit të RCC-së, *të përmendur më parë, shkalla mesatare e punësimit për të rinjtë me nivel të ulët arsimit* (përveç Shqipërisë) është 7.2% - më pak se gjysma e mesatares evropiane 18.5% e BE-së. Edhe pse është dukshëm më mirë, shkalla rajonale **e punësimit për të rinjtë me arsim të lartë** është 41.4% gjë që dukshëm është nën mesataren e BE-së prej 57.3%.

<sup>2</sup> Studimi mbi punësimin e Rinisë në Ballkanin Perëndimor, RCC, 2021, <https://www.rcc.int/docs/573/study-on-youth-employment-in-the-western-balkans>, vizituar më 11 mars 2024.

<sup>3</sup> Shkalla e papunësisë së Rinisë në Bashkimin Europian për 2022, Eurostat, <https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tesem140/default/table?lang=en>



Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë zbatuar një gamë të larmishme **strategjish për zhvillimin e punësimit**, disa prej të cilave janë projektuar veçanërisht për të synuar të rinjtë të cilët shumë herët e kanë braktisur shkollën ose për të rinjtë në përgjithësi. Punësimi në Bosnjë dhe Hercegovinë është decentralizuar dhe kjo menaxhohet kryesisht në nivel entiteti.

Disa ekonomi po përpiqen të rivendosin lidhjet midis shkollave profesionale të mesme dhe sektorit të biznesit duke **përvetësuar sistemet e dyfishta të arsimit**, pasi shkollat profesionale shpesh nuk ua ofrojnë nxënësve aftësitë e kërkuara të nevojshme në tregun e punës (Mali i Zi, Serbia).

Mbështetja për vetëpunësim, subvencionet për punësim dhe zhvillimi i drejtpërdrejtë i projekteve dhe programeve të punëve publike janë mënyra në të cilat ofrohet mbështetja e punësimit. **Subvencionet për paga** të përdorura në një numër ekonomish të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë\*, Serbi) për të ndihmuar në krijimin e vendeve të punës për të rinjtë.

Shumica e ekonomive, duke përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, kanë **krijuar iniciativa të veçanta për të mbështetur të rinjtë në procesin e kalimit në vetëpunësim**. Një komponent i rëndësishëm i programeve të punësimit të të rinjve është **veprimtaria sipërmarrëse e të rinjve**. Mjedisi institucional për veprimtarinë sipërmarrëse të të rinjve në rajon është larg të qenit i përsosur. Për shkak të mungesës së përvojës, të rinjtë kanë vështirësi t'i kapërcëjnë pengesat administrative dhe burokratike dhe nuk janë në gjendje të sigurojnë mjete financiare për biznesin e vet. Ndihma e cila u ofrohet përmes OSHC-ve dhe iniciativat qeveritare janë minimale.

### 1.1.1. Garancia për të rinjtë

Zbatimi i Programit të Garancisë për të Rinjtë është në faza të ndryshme në vendet e Ballkanit Perëndimor. Planet **e Zbatimit të Garancisë për të Rinjtë** janë miratuar në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, **me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës**.

Miratimi i Planit zbatues Garancia për të Rinjtë dhe institucioni përgjegjës për zbatimin e tij		
Shqipëria	U miratua në prill 2023	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
BeH	Ende nuk është miratuar	Ministria për Çështje Civile
Kosova*	U miratua në nëntor 2022	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Maqedonia Veriore	U miratua në mars 2023	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë
Mali i Zi	U miratua në korrik 2024	Ministria e Punës, Punësimit dhe Mirëqenies Sociale
Serbia	U miratua në dhjetor 2023	Ministria e Punës, Punësimit, e Çështjeve të Veteranëve dhe Sociale

Të gjitha 6t ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (WB6), përveç Bosnjë-Hercegovinës, i kanë vendosur **programet me pagesë për praktikë**. Secila nga këto vende ka iniciativa për mbështetjen e **punës praktike**. Asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk e ka zbatuar ende **programin e aftësimin profesional**.

**Nga viti 2018 Maqedonia e Veriut është vendi më i suksesshëm i Ballkanit Perëndimor** në zbatimin e Garancisë për të Rinjtë. Qëllimi i vendosur në bazë të të cilit Garancia për të Rinjtë në Maqedoninë e Veriut do të vlerësohej si e suksesshme është që të paktën 30% e personave të përfshirë në aktivitetet e Garancisë të dalin me sukses prej saj, qoftë me punësim, me ripërfshirje në procesin arsimor ose të përfshihet në programet aktive dhe në masat e punësimit brenda një periudhe katërmujore. Në vitin 2021, nga numri i përgjithshëm i personave që hynë në procesin e Garancisë për të Rinjtë (19.322), 8.064 të rinj deri në 29 vjeç, ose 41%, e kanë siguruar punësimin ose kanë fituar aftësi që e kanë përmirësuar punësimin e tyre <sup>4</sup>.

4 EU's Progress Report on North Macedonia 2023, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/28a9322a-3f18-434e-89d20890c90b2f96\\_en?filename=SWD\\_2023\\_693%20North%20Macedonia%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/28a9322a-3f18-434e-89d20890c90b2f96_en?filename=SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf), vizituar më 1 dhjetor 2023.



## 1.1.2. Rekomandimet për fushën e punësimit në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Garancinë për të Rinjtë

- ✓ Të bëhen **masa për përforcimin e aftësive të të rinjve** dhe reduktimin e papunësisë , veçanërisht për kategoritë e prekura (vulnerabël) të të rinjve.
- ✓ Të promovohet dhe **të rritet mbështetja për ndërmarrësinë rinore.**
- ✓ Të përmirësohen **politikat e punësimit për punët e gjelbra** në të gjithë rajonin
- ✓ Të përshpejtohet **miratimi i Planit të Zbatimit të Garancisë për të Rinjtë në Bosnjë dhe Hercegovinë**
- ✓ Të sigurojë **vazhdimësinë e zbatimit të programit të Garancisë për të Rinj në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor** me Planin e zbatimit të Garancisë për të Rinj, i miratuar në mënyrë që të mund të zbatohet programi në tërë territorin.
- ✓ Të **krijohen programe praktike, ndjekje pune, vullnetarizmi** dhe mënyra të tjera inovative nga administrata publike për t'i lidhur të rinjtë me punëdhënësit duke përdorur procedura administrative të thjeshtësuara për të gjitha palët që aplikojnë në këto programe.
- ✓ Të krijohet **koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse arsimore dhe institucioneve që merren me politikat sociale dhe punësimin** për t'i përshtatur programet arsimore, reduktimet e prodhimit të tepërt të profileve specifike të aftësive duke përmbyshur kërkesat dhe nevojat e tregut.
- ✓ Të **krijohen qendra trajnimi, ambiente trajnimi dhe qendra këshillimi për karrierë**, të fokusuar për zhvillimin e aftësive profesionale të të rinjve.



## 1.2. Arsimi – Përfundimet Kryesore

Sistemet arsimore në rajon po përballen me **sfida në sigurimin e aftësive të cilat u nevojiten të rinjve në tregun modern të punës**.

Pothuajse **të gjitha vendet e rajonit e kanë zhvilluar dhe zbatuar strategjinë arsimore, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës**, ku korniza e përbashkët për arsimin përbëhet nga disa dokumente të politikave publike. Politikat arsimore në Bosnje dhe Hercegovinë janë të decentralizuara, me përgjegjësi të ndara ndërmjet njësive dhe kantoneve.

**Mali i Zi kërkon strategji arsimore më gjithëpërfshirëse**. Nuk ka strategji unike/të vetme, gjithëpërfshirëse për të gjithë sistemin arsimor; përkundrazi, korniza strategjike në arsim përbëhet nga strategji individuale të përshtatura për segmente të veçanta të sistemit siç janë:

Strategjia për arsimin e hershëm dhe parashkollor<sup>5</sup>, Strategjia për zhvillimin e arsimit profesional<sup>6</sup>, Strategjia e arsimit gjithëpërfshirës<sup>7</sup>, Strategjia e arsimit të të rriturve<sup>8</sup> etj.

Hulumtimet tregojnë se **të rinjtë nga Maqedonia, Shqipëria dhe Serbia** janë ndër grupet më të sigurta se ka **korrupsion të përhapur në sistemin arsimor**, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kënaqësia e të rinjve me sistemin arsimor në tërësi është më e lartë se sa pakënaqësia e tyre në të gjithë rajonin. Shumica e **të rinjve besojnë** se arsimi në shkolla dhe në universitete  **nuk është i përgatitur në mënyrë adekuate për kërkesat e tregut bashkëkohor të punës**. Ekspertiza dhe arritja arsimore shpesh konsiderohen si dytësore ndaj statusit social dhe përfitimeve që rrjedhin nga punësimi.

### 1.2.1. Rekomandimet për arsimin

- ✓ Të **modernizohen sistemet arsimore** në të gjithë rajonin për t'u ofruar të rinjve aftësitë e nevojshme për tregun modern të punës
- ✓ Të **përmirësohet infrastruktura e sistemit arsimor**, duke përfshirë meremetim në ndërtesa, pajisje, metodologji të mësimdhënies dhe integrimin e teknologjive ndihmëse (pajisjeve përshtatëse dhe riaftësuese për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit).
- ✓ Të **zhvillohen kompetenca të përgjithshme dhe kritike** te studentët dhe të gjithë individët e angazhuar në mësim
- ✓ T'i **përforcohen kapacitetet e burimeve njerëzore brenda sektorit të arsimit**, duke përfshirë personelin drejtues, stafin dhe shërbimet profesionale
- ✓ Ta **përmirësohet sistemi e vlerësimit dhe evoluimit** në të gjitha nivelet akademike
- ✓ Ta **integrohet një program gjithëpërfshirës i edukimit mbi të shëndetit mendor** në kurrikulën kombëtare
- ✓ Të krijohen **shërbime të shëndetit mendor në shkolla** ose partneritete me organizatat e shëndetit mendor në komunitet për të ofruar grupe mbështetëse për studentët që përballen me sfida të shëndetit mendor
- ✓ Ta **luftohet stigma lidhur me sëmundjet mendore** brenda shkollave.

5 Strategjia për arsimin e Hershëm dhe parashkollor në Mal të Zi 2021-2025, <https://www.gov.me/clanak/strategjia-ranog-i-predskolskog-vaspitanja-i-obrazovanja-2021-2025-sa-akcionim-planom>, vizituar më 22 nëntor 2023

6 Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Profesional në Mal të Zi 2020-2024, <https://www.gov.me/dokumenta/3f8ece83-b549-4c84-8ae9-a8620ff67928>, vizituar më 22 nëntor 2023.

7 Strategjia e arsimit gjithëpërfshirës në Mal të Zi 2019-2025, <https://www.unicef.org/montenegro/en/reports/montenegro-inclusive-education-strategy>, vizituar më 22 nëntor 2023

8 Strategjia e arsimit të të rriturve 2015-2025, <http://nasedoba.me/wp-content/uploads/2016/02/5-Strategjia-obrazovanja-odraslih-1.pdf>, vizituar më 22 nëntor 2023.



### 1.3. Shëndeti Seksual Dhe Riprodhues – Përfundimet Kryesore

Kuadri strategjik dhe ligjor në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues të të rinjve është më pak i zhvilluar sesa në fushën e punësimit dhe arsimit në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo reflektohet në më pak strategji, plane veprimi, programe, ligje dhe rregullore në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor.

Në Shqipëri, ka ekzistuar Strategjia kombëtare për sigurinë e mjeteve kontraceptive për periudhën nga viti 2017 deri në 2021<sup>9</sup>, me të cilën janë siguruar të gjithë burrat dhe gratë në Shqipëri për nevoja të planifikimit të familjes, mund të zgjedhin, të marrin, të sigurojnë dhe të përdorin shërbime të cilësisë së lartë të planifikimit të familjes, si edhe mjete kontraceptive. Ligji nr. 8876 për shëndetin riprodhues nënkupton që "adoleshentët dhe të rinjtë e gëzojnë të drejtën për informacion dhe shërbime në lidhje me shëndetin riprodhues, për informacion dhe programe që synojnë t'i parandalojnë shtatzënitë dhe abuzimet e padëshiruara, dhe për gjithçka tjetër që lidhet me sjelljen e tyre aktive seksuale, në përputhje me moshën e tyre".<sup>10</sup>

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, nuk ka strategji gjithëpërfshirëse në nivel shtetëror në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues, dhe kjo fushë është e rregulluar në mënyrë strategjike në nivel entiteti. Ekzistojnë dy ligje të nivelit shtetëror që kanë të bëjnë me këtë fushë: Ligji për Kushtet dhe procedurën për ndërprerjen e shtatzënisë dhe Ligji për barna<sup>11</sup>.

Strategjia për përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të drejtat në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, 2010-2019<sup>12</sup> u fokusua te të rinjtë në kuadër të dy prioriteteve strategjike: promovimi i shëndetit seksual dhe riprodhues në kontekstin e stileve të jetesës së shëndetshme, zvogëlimi i rrezikut të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, shtatzënisë së parakohshme ose pranimit të qëndrimeve të ndryshme në fushën e shëndetit riprodhues seksual, si edhe sigurimi i nivelit më të lartë të njohurive për sa i përket shëndetit seksual dhe riprodhues përmes arsimit formal dhe joformal.

Strategjia për përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues në Republikën Serpska 2019-2029<sup>13</sup> thekson se të rinjve u mungojnë shërbimet e duhura të përshtatura për nevojat e tyre unike dhe periudhën e ndjeshme të jetës që janë duke kaluar aktualisht. Disa masa të planifikuara për zbatimin e qëllimeve të veçanta i kanë si qëllim të rinjtë. Këto masa janë vendosur për të reduktuar rrezikun e transmetimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të popullatës; të forcojë edukimin formal të bazuar në dëshmi të të rinjve për shëndetin seksual dhe riprodhues të të rinjve; organizimi i edukimit të bashkëmoshatarëve për shëndetin seksual dhe riprodhues. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Serpska e rregullojnë kujdesin shëndetësor veçmas përmes Ligjit për sigurimin shëndetësor dhe Ligjit për kujdesin shëndetësor<sup>14</sup>.

Në Kosovë\*, është miratuar Ligji Nr. 02/L-76 për shëndetin riprodhues<sup>15</sup> dhe Ligji nr. 03/L-110 për ndërprerjen e shtatzënisë<sup>16</sup>, i cili specifikon më tej procesin e ndërprerjes së shtatzënisë dhe i jep të drejtën çdo vajze dhe gruaje të vendosë lirisht për ndërprerjen e shtatzënisë sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Në vitin 2023, Kosova\* është duke hartuar Ligjin e veçantë për shëndetin riprodhues dhe konceptimin e mbështetur mjekësor<sup>17</sup>.

Në Mal të Zi, në Strategjinë e zhvillimit të kujdesit shëndetësor 2023-2027<sup>18</sup> me Planin e veprimit për periudhën 2023-2024, analiza e situatës vë në pah problemet në fushën e sigurimit të qasjes për

9 Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kontraceptive e Republikës së Shqipërisë 2017-2021, <https://albania.un.org/en/46613-albanian-national-contraceptive-security-strategy-2017---2021>, vizituar më 14 mars 2024.

10 Ligji nr. 8876 i Shëndetit Riprodhues në Republikën e Shqipërisë, <https://legislationline.org/albania>, vizituar më 14 mars 2024.

11 Ligji për kushtet dhe procedurat për ndërprerjen e shtatzënisë dhe Ligji për barna <https://www.ohr.int/laws-of-bih/>, vizituar më 10 dhjetor 2023.

12 Strategjia për përmirësimin e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, 2010-2019, [https://ba.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/inquiry\\_on\\_sexual\\_and\\_reproductive\\_health\\_and\\_reproductive\\_rights\\_in\\_bih.pdf](https://ba.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/inquiry_on_sexual_and_reproductive_health_and_reproductive_rights_in_bih.pdf), aksesuar më 10 dhjetor 2023.

13 Strategjia për përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues në Republikën Serpska 2019-2029, [https://www.unfpa.org/sites/default/files/board-documents/CPE\\_Final\\_Bosnia\\_and\\_Herzegovina\\_Programme\\_Evaluation\\_Report.pdf](https://www.unfpa.org/sites/default/files/board-documents/CPE_Final_Bosnia_and_Herzegovina_Programme_Evaluation_Report.pdf), vizituar më 2023 dhjetor

14 Ligji për kujdesin shëndetësor <https://www.ohr.int/laws-of-bih/>, vizituar më 10 dhjetor 2023

15 Po aty.

16 Ligji nr. 03/L-110 i Përfundimit të Shtatzënisë dhe Ligji në Kosovë\*, vizituar më 20 dhjetor 2023

17 Ligji i Sistemit Riprodhues dhe Medikimit Konceptual të Asistuar, <https://www.kuvendikosoves.org/eng/projektligjet-dhe-ligjet/laws/>, vizituar më 20 dhjetor 2023

18 Strategjia e zhvillimit të Kujdesit shëndetësor të alit të Zi 2023-2027 [https://extranet.who.int/economyplanningcycles/sites/default/files/planning\\_cycle\\_repository/montenegro/monte\\_negro.prf](https://extranet.who.int/economyplanningcycles/sites/default/files/planning_cycle_repository/montenegro/monte_negro.prf), vizituar më 22 nëntor 2023.

shërbime universale të kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues. Ky dokument nuk i përmban masat as aktivitetet si përgjigje lidhur me sfidën e theksuar.

Strategjia për të rinjtë 2023-2027 përfshin krijimin e një grupi aktivitësh ndërsektoriale për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së të rinjve përmes informimit të të rinjve për shëndetin seksual dhe riprodhues përmes programeve të shërbimeve të të rinjve dhe arsimit formal (arsimi fillor, i mesëm dhe i lartë). Fusha e shërbimit seksual dhe riprodhues në Mal të Zi rregullohet me këto ligje: Ligji për kujdesin shëndetësor, Ligji për kushtet dhe procedurat për ndërprerjen e shtatzënisë, Ligji për të drejtat e pacientëve, Ligji për kujdesin shëndetësor të pacientit, Ligji për trajtimin e infertilitetit me teknologji të asistuar riprodhuese, Ligji për sigurimet shëndetësore dhe Ligji për barna<sup>19</sup>.

Në Maqedoninë e Veriut, Strategjia kombëtare për barazi gjinore 2021-2030<sup>20</sup> siguron disa të drejta dhe mjete për arritjen e këtyre të drejtave për vajza dhe gra në fushën e riprodhimit dhe kontracëptionit. Është hera e parë që kjo Strategji e thekson edukimin për të drejtat seksuale dhe riprodhuese si një objektiv i veçantë dhe specifik.

Në Serbi, në Programin kombëtar për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues të qytetarëve të Republikës së Serbisë<sup>21</sup>, theksohet se praktika e kontrollit të lindjes të të rinjtë është kryesisht konservatore, se sjellja seksuale e të rinjve është e rrezikshme dhe se shkalla e angazhimit në ruajtjen e shëndetit seksual dhe riprodhues i tërë popullsisë, duke përfshirë grupet e privuara dhe të marginalizuara, është e pakënaqshme. Analiza e planeve dhe programeve që synojnë arsimin në shkollat fillore dhe të mesme tregojnë se nuk ka qasje sistematike dhe gjithëpërfshirëse ndaj arsimit kur bëhet fjalë për të drejtat seksuale dhe riprodhuese dhe shëndetin e fëmijëve dhe të rinjve në Serbi. Ligjet që e rregullojnë ndalimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e barazisë gjinore në Serbi, si dhe disa ligje në fushën e shëndetësisë, obligojnë sigurimin e kushteve të përshtatshme të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë të drejtat seksuale dhe riprodhuese dhe shëndetin e grave. Ligji për procedurat për ndërprerjen e shtatzënisë në institucionet shëndetësore i rregullon kushtet dhe mënyrën e kryerjes së këtyre lloj intervenimeve. Ligji për Ndalimin e diskriminimit<sup>22</sup> garanton që të rinjtë të kenë qasje të barabartë në mundësitë në arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe shërbime të tjera thelbësore.

### 1.3.1. Rekomandimet për shëndetin seksual dhe riprodhues

- ✓ Të **integrohet edukimi seksual gjithëpërfshirës** në kurrikulat e arsimit fillor
- ✓ Të fillojnë fushatat e synuara për ngritjen e vetëdijesimit për lirinë e seksualitetit dhe shëndetin seksual, drejtuar të gjithë të rinjve, prindërve dhe stafit arsimor
- ✓ Të përmirësohet **disponueshmëria dhe çasja e shërbimeve të planifikimit familjar** dhe mjeteve kontraceptive moderne
- ✓ Të forcohen kapacitetet ekzistuese dhe **të përmirësohet çasja në shërbimet** që kanë të bëjnë me shërbimin seksual dhe shëndetësor
- ✓ Të përmirësohet **disponueshmëria e produkteve menstruale dhe higjienike** për të gjitha gratë e reja
- ✓ Të **rritet vetëdija në lidhje me kontrollet e rregullta parandaluese për shëndetin seksual dhe riprodhues** të të rinjtë, me fokus të veçantë të të rinjtë seksualisht aktivë
- ✓ Të **inkurajohet pjesëmarrja e të rinjve në** proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues.

19 Po aty.

20 Strategjia Kombëtare e Integritimit Gjinor në Republikën 2021-2030, [https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2022-03/GRBMagazine\\_Issue1Winter2022-1.pdf](https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2022-03/GRBMagazine_Issue1Winter2022-1.pdf), posećen 1. decembra 2023 vizituar, më 10 janar 2024.

21 Programi kombëtar për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues të qytetarëve të Republikës së Serbisë [http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old/t/t2018\\_01/t01\\_0025.htm](http://demo.paragraf.rs/demo/combined/Old/t/t2018_01/t01_0025.htm), vizituar më 10 janar 2024

22 <sup>20</sup>Ligji kundër diskriminimit, <https://azil.rs/en/wp-content/uploads/2017/04/antidiscrimination-law-serbia.pdf>, vizituar më 10 janar 2024.



Përmbledhje E  
Përfundimeve Kyçe  
Analiza Krahasuese  
E Politikave Të  
Rinisë Në Ballkanin  
Perëndimor

**RYDE**  
Regional Youth Dialogue  
for Europe



Funded by  
the European Union

# 2 Youth Participation – Key Findings



## 2. Pjesëmarrja E Të Rinjve – Përfundimet Kryesore

**Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë miratuar Strategjitë kombëtare për të rinjtë**, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës. Problemet e të rinjve në Bosnjë dhe Hercegovinë janë kryesisht përgjegjësi e entiteteve dhe nuk ka strategji dhe ligj për Rininë në nivel kombëtar. **Republika Sërpska dhe Distrikti Bërçko i miratuan Strategjitë e veta për të rinjtë**, por Strategjia Rinore e Federatës së BeH është në proces miratimi që nga prilli 2024. Në Raportin e fundit të Progresit<sup>23</sup> për BeH nga BE, vihet re se "Bosnja dhe Hercegovina duhet të punojë për strategjinë e të rinjve në nivel ekonomik që do të sigurojë trajtim të barabartë për të rinjtë".

Për sa u përket **Planeve kombëtare të veprimit për të rinjtë**, situata është **përgjithësisht e qëndrueshme** në të gjithë rajonin. Bosnja dhe Hercegovina veçohet si përjashtim, ku mungojnë dokumentet e politikave rinore në nivel kombëtar. Disa entitete nënshtetërore kanë miratuar strategji dhe plane veprimi lokale për të rinjtë dhe miratimi i kornizave rinore në të gjitha nivelet e qeverisjes ka ende nevojë për përmirësim.

Në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, **legjislacioni për të rinjtë mbështet parimin e pjesëmarrjes së të rinjve**. Gjithashtu, dokumentet kryesore të politikave strategjike (kryesisht strategjitë kombëtare për të rinjtë) në çdo ekonomi përmbajnë një synim kushtuar rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve. Megjithatë, ekziston në ndryshim i madh kur bëhet fjalë për përmbajtjen e nën-qëllimeve/masave për ta arritur këtë qëllim.

Në shumë vende, për shembull, **ky synim zbatohet kryesisht përmes rritjes së kapaciteteve të organizatave rinore dhe promovimit të vullnetarizmit**. Theksi në ngritjen e vetëdijes dhe informimin e të rinjve për mundësitë për pjesëmarrje është më pak i shpeshtë, gjë që është edhe rasti me bashkëpunimin dhe mobilitetin ndërkombëtar. Në **Maqedoninë e Veriut**, fokusi është vënë në **mbështetjen e aktivizmit të të rinjve** në fusha specifike, si **mjedisi dhe hapësira dixhitale**, gjë që nuk është rasti në ekonomitë e tjera.

**Shqipëria dhe Mali i Zi garantojnë në mënyrë eksplicite të drejtat** dhe mbrojtjen e të rinjve në Kushtetutat e tyre, ndërsa vetëm **në Kosovë\* dhe Maqedoninë e Veriut ekzistojnë Ligjet që garantojnë pjesëmarrjen e të rinjve**: Ligji për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të Rinjve<sup>24</sup> në Kosovë i miratuar në vitin 2009 dhe Ligji për Pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat e të rinjve në Maqedoninë e Veriut. **të miratuara në vitin 2020**, dhe

Nga ana tjetër, ka shumë iniciativa të tjera rajonale dhe evropiane që promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve, si Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor i krijuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Dialogu Rinor i BE-së etj. **Serbia është aktualisht e vetmja ekonomi në Ballkanin Perëndimor** dhe i vetmi vend jashtë BE-së që është duke **zbatuar Dialogun Rinor të BE-së - EUYD**<sup>25</sup>, si një mekanizëm i strukturuar komunikimi midis të rinjve dhe vendimmarrësve. Me qëllim të zbatimit efektiv të EUYD-së në Serbi, në vitin 2021 u krijua Ekipi i Përhershëm i Ekspertëve në EUYD. Grupi koordinues ndërsektorial, i cili ekziston vetëm në vendet anëtare të BE-së, u krijua gjithashtu në kuadër të Këshillit Rinor të Qeverisë së Republikës së Serbisë, si organ këshillimor.

**Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova\* janë të vetmet ekonomi të Ballkanit Perëndimor, parlamentet kombëtare të të cilave kanë komisione të dedikuara për çështjet e të rinjve**. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, parlamentet e të dy entiteteve, si dhe distrikti Bërçko, kanë trupa punues që merren me çështjet e rinisë: Komiteti për Çështjet e Fëmijëve, të të Rinjve dhe Sporteve (Asambleja Kombëtare e Republika Sërpskës), Komisioni për Çështjet Rinore (Dhoma e Përfaqësuesve të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës) dhe Komisioni për të Rinjtë (Kuvendi i Distriktit të Bërçkos). Ekzistenca e të tri organeve rregullohet me ligjet përkatëse.

23 European Union, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_691%20Bosnia%20and%20Herzegovina%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_691%20Bosnia%20and%20Herzegovina%20report.pdf), vizituar më 29 prill 2024.

24 Kosovo Assembly. *Law on empowerment and participation of youth*, 30 September 2009, <https://rb.gy/fbhjue>, vizituar më 15 qershor 2024.

25 "Në dialogun me të rinjtë dhe rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes në Serbi". Politeia Institute. <https://shorturl.at/Ml4az>, vizituar më 15 qershor 2024.



**Korrupsioni dhe mungesa e besimit në institucionet publike i largon të rinjtë nga pjesëmarrja** në proceset politike dhe sociale. Studimi "Ardhmëritë e përbashkëta: Pjesëmarrja e të rinjve në paqe në Ballkanin Perëndimor" (2021), i cili përfshiu të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, zbuloi se forma më e zakonshme e angazhimit të të rinjve (15-29) në 12 muajt e mëparshëm ishte postimi në rrjetet sociale për një çështje të rëndësishme politike dhe sociale (17.2%), e më pas nënshkrimi i petitionit (14.3%), duke u bërë vullnetar për kauzë të rëndësishme (11.2%), pjesëmarrja në fushatë (9.8%) dhe pjesëmarrja në demonstrata (5.6%).<sup>26</sup>

Ky studim gjithashtu i pyeti të rinjtë për shkallën e pjesëmarrjes së tyre në politikë dhe interesimi për pjesëmarrje, me të cilin rast si pjesëmarrja aktuale ashtu edhe interesi për të marrë pjesë janë mjaft të ulëta, megjithëse **jo shumë të ndryshme nga mesatarja e Bashkimit Evropian** – një sondazh i publikuar në prill 2024 nga Eurostati tregon se 7 % e të rinjve në BE kanë marrë pjesë në aktivitetet e një partie politike apo organizate politike në 12 muajt e fundit.<sup>27</sup> Kjo e bën **pjesëmarrjen në politikën aktuale në Bosnje dhe Hercegovinë (11%) dhe në Mal të Zi (10.4%) më të lartë se në mesataren e BE-së.**

## 2.1. Rekomandimet për pjesëmarrjen e të rinjve

- ✓ Të **krijohet dhe të mundësohet funksionimi i rregullt** i mekanizmave të parashikuar për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse në vendet e Ballkanit Perëndimor si **këshilla të të rinjve**.
- ✓ Të **vendoset Dialogu i të Rinjve i BE-së** në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (Serbia e ka bërë tashmë)
- ✓ Të **krijohen komisionet parlamentare për çështjet e të rinjve** në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (BeH dhe Kosova\* tashmë e kanë bërë këtë)
- ✓ Ta zhvillojë dhe **përmirësojë kulturën e komunikimit ndërmjet të rinjve dhe vendimmarrësve** në rajon për shkak të nivelit të ulët të besimit të të rinjtë e Ballkanit Perëndimor në institucione.
- ✓ Që **ta mundësojë qëndrueshmërinë financiare afatgjatë** të organizatave rinore në Ballkanin Perëndimor dhe ta zvogëlojë varësinë nga donatorët duke diversifikuar burimet e financimit, duke eksploruar metoda inovative për mbledhjen e fondeve ose duke krijuar partneritete me sektorin privat për të siguruar autonominë dhe fleksibilitetin e organizatave rinore në adresimin e nevojave të të rinjve.
- ✓ Të promovohet dhe **të krijohet korniza gjithëpërfshirëse që inkurajohen iniciativat kërkimore për të rinjtë** në sferën akademike dhe joakademike që përfshijnë krijimin e strukturave, politikave dhe mekanizmave financues.



<sup>26</sup> Dakash, Susanna, et al. #Sharedfutures: Youth Perception of Peace in the Western Balkans. UNDP, 2021. p. 58.

<sup>27</sup> European Commission, Directorate-General for Communication. Flash Eurobarometer 545: Youth and Democracy. 2024, p. 18.

Përmbledhje E  
Përfundimeve Kyçe  
Analiza Krahasuese  
E Politikave Të  
Rinisë Në Ballkanin  
Perëndimor

**RYDE**  
Regional Youth Dialogue  
for Europe



Funded by  
the European Union

# 3 Media, Culture and The Digital World





# 3. Mediat, Kultura Dhe Bota Digjitale

Korniza institucionale **dhe ligjore në lidhje me median, kulturën dhe sferën dixhitale** në kontekstin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor janë **kryesisht të zhvilluara mirë**. Megjithatë ka shumë çështje ekzistuese, kryesisht në formën e rritjes së migrimit të të rinjve, koordinimit dhe bashkëpunimit të pakënaqshëm ndërmjet sektorëve të ndryshëm përgjegjës për rininë, mungesës së buxhetit për programe specifike, mbështetjes së dobët të arsimit dixhital dhe mediatik, modeleve të centralizuara të vendimmarrjes në lidhje me çështjet e të rinjve, etj.

Përpjekjet për të rritur arsimin mediatik te të rinjtë për avancimin e kompetencave dhe mirëkuptimit dixhital po përparojnë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Sektori **qytetar është shumë aktiv në përmirësimin e arsimit mediatik** dhe mundësive për **përvetësimin e aftësive dixhitale nga të rinjtë** në të gjithë rajonin. Në raste të caktuara, arsimimi mediatik dhe dixhital integrohen në programe dhe iniciativa të specializuara, ndërsa në të tjera, ato kultivohen në lidhje me projektet e ndryshme që lidhen me këtë fushë.

Kur bëhet fjalë për kulturën, në Ballkanin Perëndimor ekzistojnë dispozita të ndryshme ligjore që **parashikojnë aktivitete për mbështetjen e krijimtarisë kulturore** dhe inovacioneve të të rinjve. Këto veprimtari kanë **karakter deklarativ dhe jo thelbësor**. Rezultatet e kufizuara në programet kulturore dhe përfshirja e të rinjve duhet të trajtohen drejtpërdrejt duke rritur alokimet buxhetore për organizatat kulturore dhe rinore për të siguruar stabilitet më të madh financiar dhe mbështetje për aktivitetet dhe programet e tyre.

Kjo analizë tregon se, në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, **ekziston nevoja urgjente për kërkime më të thelluara për marrëdhëniet midis të rinjve dhe medias, kulturës dhe botës dixhitale**. Një hulumtim i tillë do të ndihmonte në gjenerimin e të dhënave konkrete dhe do të informonte prioritetet dhe strategjitë kryesore për të ardhmen. Materialet aktuale rrjedhin kryesisht nga raporte dhe projekte që trajtojnë këto çështje vetëm pjesërisht ose brenda konteksteve më të gjera si punësimi i të rinjve, arsimi, liria e medias, etj.

## Rekomandimet e përgjithshme për median, kulturën dhe botën dixhitale:

- ✓ Të **realizohet një kërkim më i thelluar për** marrëdhëniet midis të rinjve dhe medias, kulturës dhe botës dixhitale
- ✓ Të **sigurohet bashkëpunim dhe komunikim më efikas** ndërmjet aktorëve përkatës në fushën e medias, kulturës dhe botës dixhitale në kontekstin e çështjeve të të rinjve
- ✓ T'i **përmirësohen mekanizmat për përfshirjen e të rinjve në krijimin e politikave** në lidhje me median, kulturën dhe hapësirën dixhitale
- ✓ T'i **prezantohen çmimet vjetore për të rinjtë** për të njohur dhe festuar punën e jashtëzakonshme në media, kulturë dhe sferën dixhitale

## 3.1. Arsimimi mediatic – PËRFUNDIMET KRYESORE

Në disa ekonomi, edukimi mediatic zbatohet në lloje të specializuara programesh dhe aktiviteteve, ndërsa në të tjera ato zhvillohen së bashku me projekte të ndryshme që lidhen me këtë fushë.

Asnjë vend në Ballkanin Perëndimor nuk e ka arsimimin mediatic si lëndë të detyrueshme në arsimin formal. Arsimimi mediatic është lëndë me zgjedhje në shkollat fillore në **Maqedoninë e Veriut**, në disa shkolla të mesme në **Kosovë\***, ndërsa në **Shqipëri**, arsimimi mediatic dhe mendimi kritik nuk janë të pranishëm as nuk mësohen në mjediset arsimore formale, pasi aspektet e ndryshme të arsimit mediatic janë pjesë e disa strategjive dhe ato përfshijnë kryesisht çështjet dhe kompetencat e medias në edukimin informativ. Pilotimi i arsimit mediatic në **Shqipëri** tregoi se sistemi arsimor do të përballet me sfidën e integritit të arsimin mediatic në sistemin arsimor dhe kalimit nga faza e pilotimit për t'u bërë pjesë e kurrikulës në të gjitha shkollat e vendit.

Në **Bosnjë dhe Hercegovinë**, nuk ka arsimim mediatic si lëndë e detyrueshme dhe nuk ka dokumente strategjike në lidhje me edukimin mediatic dhe informativ në nivel shtetëror dhe as në nivelet më të ulëta të qeverisjes.

**Në Serbi**, lënda "Gjuha, mediat dhe kultura" u fut si lëndë me zgjedhje në shkollat e mesme dhe disa shkolla profesionale.

**Mali i Zi** është shembulli më i spikatur për futjen e **arsimit mediatic si lëndë me zgjedhje në gjimnaze** (shkolla të mesme) në vitin 2009. Për vitin shkollor 2023/2024 u është vënë në **dispozicion nxënësve të klasave të larta të shkollave fillore** (konkretisht, në klasën e shtatë, të tetë dhe të nëntë). Megjithatë, Strategjia e parë për media 2023-2027 në Mal të Zi, e miratuar në tetor të vitit 2023, bashkë me Planin e veprimit për periudhën 2023-2024, thekson se lëndët e arsimit mediatic në shkollat e mesme janë të kufizuara dhe se nuk bëhet mjaftueshëm promovimi në shkolla dhe ekziston mungesa në trajnimin e vazhdueshëm për mësues.

**Përfaqësimi i të rinjve nga Ballkani Perëndimor në media** është ende i pakënaqshëm. Arsyt kryesore për këtë ndryshojnë nga ekonomia në ekonomi, por disa nga problemet e përbashkëta e përfshijnë kuadrin institucional, mungesën e motivimit nga mediat dhe shpesh buxhetimin nga shumë anë. Pjesëmarrja e ulët e të rinjve në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor tregon se sistemet zakonisht nuk e njohin vlerën e të rinjve dhe potencialin e tyre si burim për zhvillimin e ekonomisë. Përfaqësimi mediatic i të rinjve në Shqipëri, sipas të dhënave të disponueshme, tregon se vetëm 28% e të rinjve janë angazhuar në aktivitete mediatike në nivel vjetor. Programet që u referohen pakicave dhe grupeve të prekura, si dhe programet e përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, janë jashtëzakonisht të nënpërfaqësuar.

### 3.1.1. Rekomandimet për arsimimin mediatic

- ✓ **Integrimi i mëtejshëm në arsimimin mediatic dhe mendimin kritik në sistemet arsimore** dhe kurrikulat akademike në të gjitha nivelet në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor
- ✓ Të **krijohet një skemë financimi afatgjatë për iniciativat në fushën e arsimit mediatic** dhe të emërohen organet që do ta mbikëqyrin zbatimin e programit
- ✓ Të **zhvillohet strategji kombëtare të mediave** me objektiva specifike që synojnë rritjen e përfaqësimit të të rinjve në media, veçanërisht grupet e të rinjve të marginalizuara
- ✓ Të **nxitë veprimtarinë sipërmarrëse mediatike midis të rinjve** duke ofruar fonde dhe mentorim për ata që janë të interesuar t'i krijojnë platformat e veta mediatike.



## 3.2. Aftësitë Digjitale – Përfundimet Kryesore

Mund të thuhet se kuadri strategjik për përmirësimin e aftësive dixhitale ekziston në vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës, por ai duhet të përmirësohet më tej. Nuk ka dokumente strategjike në BeH në lidhje me aftësitë dixhitale në nivel shtetëror dhe as në nivelet më të ulëta të pushtetit.

Në **Serbi** ekziston Strategjia e zhvillimit të aftësive dixhitale 2020-2024<sup>28</sup>, bashkë me Planin e veprimit, i miratuar në vitin 2023. Qëllimet e Strategjisë përfshijnë përmirësimin e kompetencave dixhitale në sistemin arsimor, si dhe të aftësive bazë dhe të avancuara dixhitale për të gjithë qytetarët.

Në **Mal të Zi**, Programi i reformave ekonomike të Malit të Zi 2023-2025<sup>29</sup> përfshin masën e reformës 4: *Dixhitalizimi i arsimit dhe zhvillimi i aftësive dixhitale*, dhe një rëndësinë e rritjes së arsimit informativ të të rinjve, që është gjithashtu në përputhje me masat dhe aktivitetet e planifikuara në Strategjinë e re për të rinjtë.

Në **Maqedoninë e Veriut**, Strategjia kombëtare për të rinjtë 2023-2027<sup>30</sup> thekson një qëllim si "përforcimi i aktivizmit rinor në hapësirën dixhitale, përmes avancimit të arsimit dixhital të zyrtarëve në institucionet lokale dhe kombëtare me fokus te zyrtarët e të rinjve". Këto aktivitete janë të parapara edhe në Planin e veprimit të Agjencisë për Rini dhe Sport 2023-2025<sup>31</sup>.

Në **Shqipëri**, dokumentet strategjike kombëtare që kontribuojnë në zhvillimin e aftësive dixhitale përfshijnë Strategjinë kombëtare të arsimit 2021-2026, Strategjinë shumësektoriale për Axfordën dixhitale dhe Planin e veprimit 2022-2026, Strategjinë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2019-2022, Strategjinë kombëtare për kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe inovacionin 2017 – 2022, dhe NDS II 2015-2020. Siç është e evidente, shumica e këtyre dokumenteve kërkojnë përditësim për periudha të mëtejshme.<sup>32</sup> NYSAP 2022-2029 për Shqipërinë fokusohet në zhvillimin dixhital si objektiv kryesor. Më konkretisht, Politika e qëllimit 2, e theksuar në këtë dokument, thotë: "Mbështetja dhe inkurajimi i inovacionit të të rinjve dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rinjve përmes arsimit cilësor në ICT dhe fusha të tjera të zhvillimit dixhital, me çfarë rriten dhe përmirësohen mundësitë për hyrjen në tregun e punës".<sup>33</sup>

**Kosova\*** vlerësohet se deri diku është e përgatitur në fushën e transformimit dixhital dhe mediave.<sup>34</sup>

### 3.2.1. Rekomandimet për aftësitë dixhitale

- ✓ Të **nxitet mjedisi pozitiv online për të rinjtë** dhe të vihen përparësitë e sigurisë dixhitale dhe aspektet etike në politikat në lidhje me hapësirën dixhitale
- ✓ Të **përmirësohet arsimit për përmbajtjen e dëmshme dhe pasojat e saj negative, me qëllim mbrojtjen e rinisë në platformat e mediave sociale.**

28 Qeveria e Republikës së Serbisë, <https://pravno-informacioni-sistem.rs/eli/rep/sgrs/vlada/strategjia/2020/21/2/reg>, vizituar më 20 prill 2024

29 Qeveria e Malit të Zi, <https://www.gov.me/dokumenta/e19b682f-19f3-4788-99f5-ca5ad1df3e4a>, vizituar më 30 prill 2024.

30 Qeveria e Maqedonisë së Veriut, <https://api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2023/10/nsm23-27-sluzhben-vesnik.pdf>, vizituar më 26 prill 2024

31 Qeveria e Maqedonisë së Veriut, <https://api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2023/10/akciski-plan-2023-2025.pdf>, vizituar më 26 prill 2024

32 ITU (2022). Shqipëria - Profili i Ekonomisë së Zhvillimit Dixhital.

33 Minister of State for Youth and Children, 2022.

34 EU report for Kosovo, 2022 [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en)

### 3.3. Politikat Kulturore – Përfundimet Kryesore

Niveli i **pjesëmarrjes së të rinjve në krijimin e politikave kulturore është i pakënaqshëm** në shumicën e ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Të rinjtë janë pjesë e grupeve më të gjera të aktorëve të përfshirë në proceset e konsultimit të vendimmarrjes, ashtu siç janë rregulluar me ligj, por nuk ka të dhëna që tregojnë që të rinjtë që merren me kulturë kanë qenë praktikisht të angazhuar. Dispozitat e ndryshme ligjore në Ballkanin Perëndimor synojnë të mbështesin krijimtarinë kulturore dhe inovacionin te të rinjtë, por zbatimi i tyre është më shumë simbolik se sa thelbësor.

**Në Bosnjë dhe Hercegovinë**, problemi më i madh është mungesa e kuadrit gjithëpërfshirës strategjik kombëtar për investime në zhvillimin e kulturës dhe sportit, me theks te të rinjtë dhe grupet e prekura, si dhe mungesa e një qasjeje sistematike. BE-ja në raportin e vet të fundit për BeH<sup>35</sup> bën thirrje për rritjen e ndarjes së mjeteve për buxhet për kulturë në të gjitha nivelet e qeverisjes me vendime financimi afatgjata dhe shumëvjeçare për të siguruar stabilitet për krijimin dhe funksionimin kulturor dhe që BeH të krijojë struktura formale partneriteti, të cilat e mundësojnë pjesëmarrjen transparente dhe të organizuar në krijimin e politikave për kulturë.

**Strategjia e politikave kulturore të Bosnjës dhe Hercegovinës**, e miratuar në vitin 2008, përmend vetëm 'artistët e rinj' dhe 'talentët e rinj' pa u fokusuar në rininë në përgjithësi dhe përfshirjen e tyre në politikat dhe aktivitetet kulturore. Megjithatë, ka disa shembuj pozitivë në nivele të ulëta. **Kantoni i Sarajevës** e miratoi **Strategjinë për zhvillimin e kulturës deri në vitin 2027**, në të cilën masa afatmesme është të mbështesë projektet që forcojnë lidhjen e fëmijëve dhe të rinjve me institucionet kulturore.

**Në Kosovë\***, Strategjia për të rinjtë 2019-2023 u fokusua në rëndësinë e pjesëmarrjes në kulturë, njohjen e kulturave të etnive të ndryshme dhe përkrahjen e të rinjve të marginalizuar, gjë që do të garantonte integrimin dhe standardet evropiane.

**Në Mal të Zi**, Ministria për kulturë dhe media për çdo vit shpall thirrje publike për mbështetjen e projekteve kulturore të të rinjve<sup>36</sup> të cilat i zbatojnë organizatat e të rinjve çdo vit.

**Në Maqedoninë e Veriut**, Strategjia kombëtare për të rinjtë 2023-2027 thekson se qasja dhe pjesëmarrja e të rinjve në kulturë është me rëndësi vendimtare, së bashku me aftësinë e tyre që të mendojnë në mënyrë kritike dhe arsimin përmes praktikës artit dhe praktikave kulturore.<sup>37</sup> Aktivitetet përfshijnë inkurajimin e zhvillimit të programeve krijuese dhe edukative në kulturë dhe art në moshën parashkollore dhe në shkollat fillore që do të nxisin interesimin për kulturën që në moshë të re dhe zhvillimin e nevojave kulturore te të rinjtë, si dhe modernizimin e programeve mësimore në institucionet e arsimit të lartë për përvetësimin e njohurive në mesin e të rinjve.

**Në Serbi**, Strategjia për zhvillimin e kulturës nga viti 2020 deri në vitin 2029 me Planin e veprimit, i cili u miratua në vitin 2020. Strategjia e rregullon sistematikisht interesin publik për kulturën dhe i përcakton prioritetet strategjike për zhvillimin e saj në periudhën e caktuar dhjetëvjeçare. Fëmijët dhe të rinjtë njihen si segmenti më i rëndësishëm në zhvillimin e nevojave kulturore, pasi jo vetëm që janë vizitorë të eventeve, por janë edhe audiencë dhe krijues të kulturës së ardhshme.



35 Bashkimi Evropian, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_691%20Bosnia%20and%20Herzegovina%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_691%20Bosnia%20and%20Herzegovina%20report.pdf), vizituar më 29 prill 2024

36 Qeveria e Malit të Zi, <https://www.gov.me/clanak/javni-konkurs-finansiranje-projekata-programa-nvo>, vizituar më 30 prill 2024

37 Qeveria e Maqedonisë së Veriut, [https://api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2023/02/nsm-23-27\\_draft.pdf](https://api.ams.gov.mk/wp-content/uploads/2023/02/nsm-23-27_draft.pdf), vizituar më 29 prill 2024



### 3.3.1. Rekomandimet për politikat kulturore

- ✓ Të **rritet pjesëmarrja e të rinjve** në zhvillimin e politikave kulturore
- ✓ Të përmirësohen **strategjitë kulturore kombëtare** me një vizion të qartë, qëllime të matshme, mbështetje për artet dhe industrinë kulturore, promovimin e diversitetit dhe përfshirjes mes të rinjve, investimet në edukimin kulturor dhe angazhimin me partnerët ndërkombëtarë
- ✓ Të **harmonizohen strategjitë kombëtare kulturore** dhe strategjitë kombëtare rinore
- ✓ Të **harmonizohen ligjet për kulturë**, me strategjitë e ratifikuara sipas konventave dhe standardeve evropiane dhe ndërkombëtare
- ✓ Të **rriten alokimet buxhetore për kulturën** në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në bashkitë lokale, dhe të sigurohet një skemë financimi afatgjatë për iniciativat dhe aktivitetet kulturore, pasi shumë projekte aktualisht varen nga mbështetja financiare e jashtme.
- ✓ Të **rriten alokimet buxhetore për organizatat kulturore dhe rinore** që të përmirësohet stabiliteti i tyre financiar dhe të mbështeten në mënyrë efektive aktivitetet të cilat i inicojnë të rinjtë.



**RYDE**

Regional Youth Dialogue  
for Europe



Funded by  
the European Union

PËRMBLEDHJE E  
PËRFUNDIMEVE KYÇE  
ANALIZA KRAHASUESE E  
POLITIKAVE TË RINISË NË  
BALLKANIN PERËNDIMOR

---

Shtator 2024.